Lezhë, më 02.12.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 02.12.2022, në orën 12:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen e radhës të muajit Nëntor 2022, të këshillit Bashkiak Lezhë, me prezencën e kryetarit të Bashkisë z. Pjerin Ndreu dhe zv/kryetarit të Bashkisë z. Ermal Pacaj. Mbledhja u hap nga kryetari i këshillit Bashkiak z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës si dhe tre projekt vendimet shtesë.

Ndue Luli: Kush është dakord me rendin e ditës duke futur dhe 3 projekt vendimet shtesë?

Agostin Marku: Me leje.
Në mbledhjen e kaluar kemi shtyrë për arsye ligjore një projekt vendim "Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore". Shoh që edhe në këtë mbledhje është depozituar projekt vendimi i njëjtë, asnjë lloj ndryshimi.
Aty vazhdon të ketë emra të të ndjerëve që ne duhet t'i japim tokë në pronësi. Jua thashë në mbledhjen tjetër, a është faji i sekretares së këshillit, apo juaji kryetar i këshillit, apo i aparatit, unë nuk e di se i kujt është por të paktën tërhiqeni. Nuk mund t'u japë këshilli të ndjerëve tokë në pronësi. Së dyti, kemi pikën 9, projekt vendim "Për shpalljen e zgjedhjeve për disa kryetarë të fshatrave". Jemi në 6 muajt e fundit të mandatit. Në kushte normale, ne kemi bërë 2 vjet

me zgjedh kryetarët e fshatrave. Nuk ka sens
të zgjidhet kryetari i fshatit për 6 muaj. Ja
ku është kryetari i Bashkisë, t'i emërojë.
Ndue Luli: Po bëj një sqarim për të dytën. Kryetarët
e këtyre fshatrave kanë dhënë dorëheqje dhe
kryesia e fshatit ekziston.
Pjerin Ndreu: Po jap një sqarim për këtë çështjen e
kryetarëve të fshatrave sepse për çështjen e tokave
e jep drejtori. Meqë jemi para zgjedhjeve, emërimi
i bërë nga kryetari i Bashkisë komprometohet,
sepse do konsiderohet politikisht. Zgjedhja më
e mirë dhe më demokratike për të mos pasur
debate, janë zgjedhjet sipas ligjit.
- Kryetari z. Luli i dha fjalën z. Ylli Përndrece, specialist
në Drejtorinë e Aseteve.
Ylli Përndrece: Z. Kryetar, në lidhje me projekt
vendimin që kemi përgatitur ne, kërkesat i kanë
bërë të gjallët, se i ndjeri nuk bën kërkesë (dhe
lexon njërin rast që është në p/vendim).
Agostin Marku: Zotëria i referohet pikës 1. dhe
nga ana tjetër thotë: i ndjeri nuk ka se si të bëjë
kërkesë. Po pika 3 ku thotë: i ndjeri. A ka
bërë kërkesë ky? Po ashtu te pika 6 thotë
i ndjeri. Mos u mundoni me kundërshtu kot.
Hiqe nga rendi i ditës. Sille në rregull, kështu
thamë edhe atë ditë, edhe për arsye të
mungesës së kuorumit.

Ylli Përndreca: kërkesa është bërë nga të gjallët. Ka pasë gjallë kur është bërë kërkesa. Dokumentacioni është parë me kronologji.

Agostin Marku: O zotëri, unë nuk po them se ajo tapi është e paligjshme, unë po them sot ai nuk jeton. Ai ka trashëgimtarë. Unë nuk po them që ti ke falsifikuar letra, ti ke bërë një lapsus dhe ky lapsus vlen për kep

Ylli Përndreca: Ti nuk e kupton këtë procedurë sepse është e re

Ndue Luli: Fjalën e ka zv/kryetari i Bashkisë për sqarim.

Ermal Paca: Për pretendimin në fjalë, procedura ligjërisht është korrekte, ajo është bërë në bazë të kërkesave të të ndjerëve. Ti Agostin e dhe mendimin tënd, drejtoria e dhe mendimin e vet. Se e bëjmë përfund këtë diskutimin, besoj që është më mirë që kryetar, t'ia paraqitrojmë këshillit për votim, që mos të rrijmë përfundimisht me një temë që ne jemi të bindur pse është bërë.

Pjesin Ndreu: Ka një problem, kjo është histori e gjatë mosmarrëveshjesh mes pushtetit lokal, pushtetit qendror dhe pretenduesve për tokë. Është një periudhë e gjatë ecejakesh dhe sorollatjesh e premtimesh elektorale. Njerëzit kanë pritur. Gjatë këtij procesi, fatkeqësisht dikush ka vdekur dhe ne kemi aplikimin, sepse ne e kemi diskutuar këtë gjë. Në proces pastaj, nëse miratohen,

qi ka një trung familjar atje, ka një certifikatë familjare dhe ata kur të aplikojnë e ndajnë veti me vendim gjykate trashëgiminë familjare. Kjo është një fazë në parim që ne i kalojmë sepse nuk mbaron këtu historia. Mbaron me një procedurë tjetër ku familjarët për ta marrë titullin e pronësisë ata i drejtohen gjykatës.
Ne nuk mund t'u themi që meqë ka vdekur babai, ta fillojmë procedurën nga fillimi. Mund të them që ne jemi nga të paktat bashki që kemi avancuar me ligjin 2020. Që mos t'i torturojmë më njerëzit. Ata aktualisht janë të bllokuar, as nuk mund ta shesin, as nuk mund të bëjnë ndonjë sipërmarrje bujqësore. Unë kam qenë gjatë kësaj kohe në kontakt me shumë njerëz nga ajo zonë, sidomos zona Rulë - Barbullojë. Ne e bëjmë në parim, ata e zgjidhin mbrapa. Ne jemi dakord që ata të marrin tokën. Fatkeqësisht dikush ka vdekur, por e zgjidhin në proces më mbrapa. Sepse nuk mbaron procesi sot.
Ylli Përndreca: kërkesa ka një efekt 6-mujor. Ka qenë deri në 7 nëntor 2020. Gjatë kësaj kohe nuk ka të drejtë më asnjë familjar që të bëjë kërkesë. Dhe sikur të refuzojmë kërkesën e atij që ka vdekur, nuk ka të drejtë të bëjë kërkesë më asnjë nga familjarët.
Ndue Luli: Dakord. Është i qartë dhe sqarimi

që dhe Kryetari.
Hedhim në votim rendin e ditës bashkë me shtesat. Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 1 e rendit të ditës që është interpelanca me kryetarin e Bashkisë në lidhje me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore kërkuar nga këshilltari Agostin Marku.
Fjalën e ka z. Agostin Marku.
Agostin Marku: Realisht unë e kam kërkuar këtë interpelancë me qëllimin e mirë, për të nxjerrë në pah se ku janë rezervat, ku janë dhe potencialet e bashkisë për të mbledhur të ardhurat në mënyrë që të kemi atë lloj menaxhimi që duhet për bashkinë, por edhe për investimet, duke i kthyer në investime për të mirat e komunitetit.
Shifrat e 4-mujorit nuk ishin bindëse dhe për kapacitetet që ka bashkia por edhe për resurset që ka Lezha, sidomos në dy drejtime, si për taksën e fjetjes në hotel, ashtu dhe për zënien e hapësirave publike, sidomos për plazhet publike.
E kërkova interpelancën edhe për një arsye tjetër, sepse ka një mentalitet të gabuar në tërësi se këshillat janë thjesht për të miratuar vendimet që vijnë nga bashkia, këshilli është edhe për të kërkuar interpelanca, për të kërkuar llogari. që

i ke në kompetencë, që ca jep ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore". Më ke ardhur një përgjigje një tape, me të cilën është njohur dhe këshilli dhe ke ardhur me ca shifra që vetëm Bashkisë Lezhë nuk i përkasin.

Pjerin Ndreu: Thuaje, çfarë problemi ka.

Agostin Marku: I kemi atje para, në vitin 2021 është 52 mln taksë e fjetjes në hotel, kapacitetet publike 270 mln. Megjithatë mua më erdhën shifrat për 2021 - 2022 për fitimet Bashkinë e Lezhës. Unë në fakt kërkova për dy njësi, Nj. A. Shënkoll dhe Nj. A. Shëngjin sepse këto dy kanë taksesë atje e kanë përqendrimin më të madh. Më thuhet që është sekret shtetëror se sa janë detyrimet e subjekteve ndaj bashkisë. Thotë e ka ligji për tatimet. Unë i lexova ligjet dhe nuk lexova kund se ka sekret shtetëror për të treguar detyrimet e subjekteve ndaj një të zgjedhuri të pushtetit vendor. Vijmë te çështja e kapaciteteve që ka bashkia, mua më pëlqen deklarata që bëri drejtori i Taksave një ditë, foli me këmbë në tokë në lidhje me atë që unë kam qejf, inventarizimin. Për 4-mujorin e pikut të sezonit, duhet të jetë 1 mln € të paktën e ardhura nga taksa e fjetjes në hotel në Bashkinë e Lezhës. Kur vjen puna te planifikimi, ne i planifikojmë shumë më pak. Sinjet, se do na dali kur të miratojmë buxhetin është një shifër shumë ambicioze,

kur edhe vlera minimale që është planifikuar vitet
e tjera, nuk është realizuar, apo zënia e hapësirave
publike, sidomos me shezllonet. Në Shëngjin janë
shumë shtetas afganë që qëndrojnë në një resort.
Zero është taksa që merr Bashkia e Lezhës.
Nona Luli: Fjalën e ka drejtori i Taksave
Driton Boçi: Ta fillojmë nga konfidencialiteti dhe
mosndarja e të dhënave shtetërore. Nuk ndodh
në asnjë lloj administrate që të nxirren të dhënat
për një subjekt të caktuar, sepse në ligjin 9920
janë të mbrojtura me ligj. Me përjashtim të
prokurorive dhe gjykatave, nuk mund të marrë
njeri të dhëna për një subjekt të caktuar.
Ndërsa për sa i përket të dhënave të tjera,
që ju keni plotësisht të drejtë, që kemi dhënë
të dhëna për gjithë Bashkinë e Lezhës, është
fatkeqësisht nga problemet që ka pasë me sistemin
e vjetër të taksave dhe mungesa e të dhënave
të plota dhe të sigurta. Duke qenë se po
punohet për implementimin e sistemit të ri, që
do jetë një ndër më të mirët në gjithë republikën,
të dhënat do jenë deri në nivel fshatrash, jo
vetëm njësie. Në lidhje me taksën e fjetjes në
hotel, i jemi përkushtuar 3 muajt e këtij sezoni,
poftë me vizitat në terren për të kryer një
inventarizim, për të evidentuar se sa hotele,
struktura akomoduese kemi nga terreni. dhe

kemi arritur të evidentojmë 205 struktura akomoduese për Shëngjinin dhe Shënkollin. Normalisht subjektet janë vetëdeklaruese dhe kjo është e mbrojtur në Kushtetutë. Kanë deklaruar 3150 dhoma fjetjeje. Me verifikimet tona në terren jemi mbi 4200, që do të thotë që subjektet kanë deklaruar më pak nga ç'janë realisht dhe mbi 12000 shtretër janë të legalizuar. Në rast se ne do të punojmë mirë si drejtori për vitin që vjen, pastaj në evidentimin e subjekteve që janë akoma pa regjistruar në QKB, pastaj me deklarimin e saktë të këtyre subjekteve aktive, pretendojmë dhe parashikimin e kemi për 50 mln të reja për vitin e ardhshëm nga taksa fjetje. Hapësira publike është një zë i veçantë që nuk e menaxhojmë vetëm ne, pasi jepet me kontrata nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit. Gjithsesi parashikimi është për 1 mld lekë për vitin e ardhshëm. Për këtë vit, për taksën e fjetjes në hotel, ne kemi gjeneruar fatura për 150 mln lekë të tjera. Arkëtimet deri në 31 tetor janë 100 mln. dhe presim që brenda vitit të mbyllet e gjithë shuma që është faturuar. Shumica e subjekteve të hotelerisë, të paktën subjektet e mëdha, këtë vit janë faturuar 50 % më shumë se vitet e mëparshme.

Pjerin Ndreu: Në parim unë jam dakord me shqetësimin e Agostinit. Problemi i sistemit të taksave është një problem që na shqetëson edhe ne si bashki. Ama ne tashmë e kemi kapur situatën. Taksa e infrastrukturës është një taksë që ka një peshë të madhe në të ardhurat e bashkisë, kjo taksë ka kulmuar në vitin 2019 sepse kanë qenë lejet e ndërtimit, pastaj ne na është bllokuar, për 3 vite, 8 leje ndërtimi. Në lidhje me taksën e fjetjes në hotel, ne kemi bërë një përllogaritje që një hotelerie i shkon 4 muaj kohë e plotë dhe i bie diku te 500 milionshi. Është llogjikë reale kjo duke llogaritur numrin e shtretërve. Në lidhje me hapësirat publike, ne kemi 528 stacione plazhi të bëra me hartë dixhitale, të miratuara në Ministrinë e Turizmit. Ne jemi të detyruar te llogarisim taksën sikur të 528 stacionet e plazhit të aplikohen, ama në fakt nuk aplikohen të gjitha nga subjektet. Aplikimin e bëjnë online, nuk e bëjnë në bashki. Te ne duhet të vijnë të paguajnë taksën. Pjesa e afganëve është një fakt historik. Ai është një problem humanitar. Ju e dini tashmë, ata janë njerëz në nevojë, njerëz në luftë. Për ta paguajnë organizatat humanitare dhe zakonisht organizatat humanitare për veprime humanitare nuk taksohen.

Nuk jemi turistë aty për kohë ardhur. Jemi njerëz në nevojë dhe ne, n.q.s do ne ishte tjetër, do i ndihmonim dhe në shtëpi. Shqiptari u ka dalë në ndihmë të gjithëve gjithmonë.

Ndue Luli: Kryetari i Kuvendit, Kryetar.

Agostin Marku: Po e filloj nga fundi. Nuk shtrohet problemi për t'u marrë me strehim afganëve, në mes atij për pagesën për llogari të afganëve. Vazhdojmë me sekretin shtetëror. Unë nuk shoh te ligji për procedurat tatimore që përben sekret informacioni, kur e kërkon i zgjedhuri, në lidhje me detyrimet e subjektit.

Dritan Boçi: Është një debat shumë teknik. Informacioni që kërkon këshilltari për çdo subjekt, nuk jepet, në total po. Në lidhje me një subjekt të caktuar jo, sepse jemi të lidhur për mbrojtjen me Kushtetutë, jo vetëm me ligj.

Ndue Luli: Atëherë e mbyllim interpelancën. dhe vazhdojmë me rendin e ditës.

Kemi pikën 2 që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Tetor 2022".

Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.

U votua pro nga të gjithë këshilltarët prezentë përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.

Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e Programit Buxhetor

Afatmesëm 2023 - 2025 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2023".
Para se të fillojmë me pyetje e diskutime, dua të falenderoj të gjithë ata këshilltarë që janë bërë pjesë e takimeve për konsultimin publik në lidhje me PBA-në.
Në lidhje me projekt-vendimin fjala për ju kryetar.
Pjerin Ndreu: Faleminderit kryetar.
Unë do them disa gjëra në vijë të përgjithshme, pastaj sipas interesit dhe atyre që mendoni ju, do japim dhe sqarimet përkatëse
→ Erdhi këshilltari Gjin Kola.
Pjerin Ndreu: Projekt buxheti është gjithmonë një dokument që ne ngarkon me përgjegjësi sepse është detajimi i të ardhurave që ne do mbledhim dhe si do shpenzohen ato. Janë pagat, sigurimet, shpenzimet operative, investimet, fondi i veçantë për emergjencat. Po të flasim për pagat, si ka lëvizur trajektorja, ka lëvizur nga 26000 në 34 000 paga minimale, është një rritje e madhe dhe në vitin 2016, 45% e buxhetit shkonte për paga, në vitin 2017, 47,8%, në 2018, 45%, në 2019, 41%, në 2020, 30,5%, në 2021, 32% ndërsa në vitin 2022, 29%. Pra, ne kemi bërë atë që duhet duke shkuar në një trajektore të kontrolluar të shpenzimeve, duke i dhënë njerëzve paga dhe duke i mbajtur në punë kuturu për fatkeqësitë

këtu ka ndodhur. Ne sot jemi në 30,2 % në buxhetin që prezantojmë duke reflektuar të gjitha rritjet e pagave që janë bërë si në pagën minimale dhe në disa funksione të deleguara, që po vijnë në formë transferte nga qeveria.

Ça është bërë me investimet dhe si vijnë investimet në trajektore në raport me buxhetin dhe do flasim për shpenzimet operative që janë çelësi i mbrapshtive që ka patur bashkia, që në fakt nuk i ka më. Ky buxhet është më i madhi, madje mendoj që do kemi realizim të të ardhurave mbi planin dhe jam i bindur që në 6-mujorin e dytë ne do rishikojmë buxhetin me ngritje. Në vitin 2016, 17% e buxhetit shkonte për investime, në 2017, 17,1%, në 2018, 19,6 %, në 2019, 20,6 %, në 2020, 31,2 %, në 2021, 29,2 %, në vitin 2022, 28,4 %, në 2023, 34%, pra shkojmë me progresion rritës, se këtu kemi vitin e tërmetit dhe vitin e pandemisë. Mos të harrojmë se ka pasur dhe fatura për t'u paguar, për të mos e përmendur borxhin se sa ka qenë.

Ça ka ndodhur me shpenzimet operative. Në 2016 kanë zënë 32%, në 2017, 38,9 %, në 2018, 33,4%, në 2019, 32,6%, në 2020, 27,8 %, në 2021, 28,7%, në 2022, 28,4 %, në 2023, 24,9 %. Pra, shumë janë që ne i bëjmë për funksionimin e administratës. Te shpenzimet operative, vërtet

shifra është më e lartë, por impakti më i ulët.
sepse nëpërmjet shpenzimeve operative ne kemi
realizuar shumë gjëra në formën e investimeve,
të punës në buxhetin kryesisht. Janë 400 km
kanale që janë hapur
Qeratë e zyrave, që kam thënë njëherë shumica,
është e fiksuar
Kemi reduktuar shpenzimet në maksimum, ndryshe
nuk do ia kishim dalë.. kemi bërë planizim real
të shpenzimeve, por dhe impakt real në jetën
e popullatës, pa harruar dhe numrin e lartë të
aktiviteteve social-kulturore që kemi bërë ne.
Neve na bie që të kemi bërë çdo 1,6 ditë një
aktivitet. Janë aktivitete për të rregulluar disa
aspekte kulturore, sportive, të jetës së përditshme
në qytet, në zonat përreth, që do i ndjekim me
përkujdesi edhe në të ardhmen.
Ne vazhdojmë të fokusohemi në zonat rurale,
vazhdojmë që pjesa më e madhe e buxhetit shkon
në zonat rurale. Në të gjitha njësitë, pa përjashtim,
shumë rrugë do stabilizohen me asfalt. Kemi
shumë zona ku do hyjmë me stabilitine me çakull.
Shumë investime janë jo vetëm me fondet e bashkisë,
por edhe me projekte me fondet e qeverisë, apo me
projekte me të huajt. dhe jo pa qëllim ne jemi
përzgjedhur një ndër 28 bashkitë në botë për
tranzicionin urban, pra që mund të investohet

në këtë fushë. Do implementojmë sistemin e ri të taksave dhe nuk do keetë më diferenca të rënda. Sistemi është elektronik, ndër më të mirët. Deri tani janë shumë aplikime në lidhje me ndikimin e taksës së infrastrukturës. Ka interes dhe po bëhen projekte të mëdha të brendeve të huaja, për shkak edhe të punëve që kemi bërë. Por dhe shpenzimet që kemi bërë gjatë fitur sezonit të verës. Janë shpenzime që ne i bëjmë sepse na duhet cilësia e plazhit.
Ne kemi bërë hapa cilësorë përpara.
Ne ruajmë ekuilibrat e një buxheti real
Do jemi absolutisht me zerim të borxheve, maksimumi 6-mujorin e parë, duke ruajtur dhe këto që kemi planifikuar.
Por edhe njerëzit duhet të ndërgjegjësohen për pagimin e taksave se ne jemi menaxhues të taksave që mbledhim. Njerëzit duhet te dinë që ne marrim 50% të kostos së pastrimit përmes tarifës së pastrimit, për t'i ruajtur abonentët familjarë nga një tarifim i lartë
→ Doli këshilltari Brahim Demi
→ Erdhi këshilltari Marklojen Lushaj.
- Ndue Lulaj: Kolemindërit kryetar.
Kush e do fjalën?
- Agostin Marku: I nderuar kryetar i Bashkisë
Unë shoh se buxheti në fakt ka rritje dhe

duhet vlerësuar. Kemi një buxhet të Bashkisë së Lezhës prej 1,7 mld lekë të reja, që nga burimet e veta shkon te 1 mld, pjesa tjetër është nga burime qendrore dhe raporti midis tyre është 60 me 40%. Ne e dimë se nga burimet qendrore janë shërbime që nuk janë në dorën e Kryetarit të Bashkisë, nuk janë në dorën e bashkisë, janë shërbime të domosdoshme por nuk kemë liri veprimi për të ndërtuar ato strategji që mendon bashkia. Nisur nga kjo, kur janë diskutimet e buxhetit, unë i bie pjesës se çfarë ke në dorë bashkia, këshilli i bashkisë, me këto resurse e kapacitete që ka, që të bëjë maksimumin e mundshëm. Unë mendoj që këto raporte duhet të ishin në një shkallë më të lartë psh: 70:30. Pse? Lirshmëria rritet më shumë për të investuar aty ku duhet. Duhet të gjenden mekanizmat që ne të bëjmë maksimumin e mundshëm për mbledhjen e të ardhurave. Unë do isha që të lihen po u investuar ay rrugë rurale dhe të investohet në teknologjinë për sistemin e mbledhjes së të ardhurave dhe kapacitetet fiskale që ka bashkia. Janë të gjitha mundësitë, po përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë se është e vërtetë që kjo taksë ndikon në përmirësimin e treguesve buxhetorë, sidomos për lirshmërinë që mund të ketë nësë bashkia edhe për të bërë investime strategjike.

Pjerin Noloma: Të diskutojmë për çdo pjesë.

Ti ngre shumë probleme. E mirë është që n.p.s shtron një problem, të jap një përgjigje.
Ke shumë të drejtë në atë që thua se e diskutuam edhe te problemi i taksave e tarifave. Atë që thatë, ne tashmë e kemi bërë, e kemi investuar. Sistemi po ngarkohet me të dhëna. E kemi parë si nevojë. Sistemi i mëparshëm nuk na ka funksionuar. Sot, atë po bëjmë ne. Qytetarit t'i pritet fatura ekzakte sipas të dhënave që ka në sistem. Dhe nëse ndonjë subjekt ka ndonjë pretendim, shkojmë dhe e verifikojmë në terren. Për sa i përket taksës së infrastrukturës, unë flas mbi aplikime të bëra, nuk flas mbi ide se çfarë do bëhet. dhe të fitle këto aplikime të bëra, vijnë për leje te ne.

Agostin Marku: Kemi 20 programe buxhetore. dhe shoh, programi i tetë p.sh., njëri rrugor zë 30% të buxhetit. Unë në parim jam dakord. Investohet në një fushë që pak vëmendje ka parë dhe në një farë mënyre transformohet infrastruktura rurale, çka ndikon në zhvillimin e shpejtë dhe transformimin uniform të të gjithë zonës, por ekziston dhe një rrezik i madh, se investimet në këtë drejtim, mbi bazën e atyre kritereve që janë, që këto investime të na përsëriten dhe ne të detyrohemi më shpesh të shpenzojmë për mirëmbajtjen.

Pjerin Ndreu: Le ta ezaurojmë këtë program

ka shumë të drejtë për shpejtësohesh, ama në të gjitha rrugët që kemi investuar ne në këto vite, asnjëherë nuk ka çeduar. Ne kemi marrë kompani serioze që kanë kapacitetin për ta bërë. Ne nuk kemi bërë ndërhyrje elektorale. Do vazhdojmë sepse kemi zona rurale të lidhura me turizmin.

Agostin Marku: Thashë janë 20 programe buxhetore. 3 programe këtu, 8, 10, 17 zënë 55% të buxhetit. Ka programe që kanë vlera të papërfillshme. Janë dy programe, 9 dhe 14, shërbimi parësor dhe transporti publik që janë zero, ndoshta s'është e arsyeshme, ndoshta infrastruktura e Lezhës e bëjnë të paarsyeshme që të investohet aty, por përsëri nuk më duket e paarsyeshme që mos të kenë asnjë lekë edhe këto programe. Në lidhje me atë që po thosha për rrugët rurale, duke bërë mirëmbajtje vazhdimisht, rrit koston, dhe nuk ka më fonde që të bëjë investime strategjike. Shpenzimet në total për pagat janë me ulje, por mos të harrojmë diçka, për çdo bashki, përsëri, rastet e realizimit të të ardhurave me tepricë janë të rralla. Mund të ketë një bum për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Por në shumicën e rasteve, sado mirë të punosh, nuk del me tepricë, del më pak nga ajo që parashikon. Të ardhurat çoji te investimet.

Pjerin Ndreu: Nëse e realizojmë atë trend që

poreshikojmë, pa dyshim që te investimet do i gjejmë.
Jo vetëm për transportin publik, por ne jemi
në komunikim me BERZH-in me një projekt për
transport publik dhe një projekt për smart city.
Jemi dakordësuar me ta. Jo çdo gjë mund ta
përballojmë me fondet e bashkisë. Do bëjmë një
studim fizibiliteti për gjithçka duhet të investojmë
në Lezhë nga A-ja te ZH-ja. Duhet të bëjmë
një plan njëherë.
Projektet që kemi bërë dhe po bëjmë nuk janë vetëm
me fondet tona

Agostin Marku: Kam edhe dy propozime. Do ishte
gjë shumë pozitive për të nxitur njerëzit për të
paguar detyrimet që kanë. Së dyti, është në ligj,
është thënë disa herë dhe nuk realizohet. Po
të kishte buxhet Këshilli Bashkiak, me ato shpenzimet
për KQ, do ishte dhe buxhet më i mirë, më efektiv.
Uroj që ta realizoni këtë program buxhetor.

Ndue Luli: Kush ka ndonjë mendim tjetër?

Hasan Miça: Të nderuar këshilltarë, jemi mësuar
që kur diskutohet një projekt buxhet në fund të
mandatit, si të jetë më shumë elektoral sesa real,
por ndryshe nga herët e tjera, ne po vimë re që
kemi të bëjmë me një p/buxhet shumë real dhe nuk
është aspak elektoral. Nga ana tjetër ne duhet të
bëjmë një vështrim kronologjik se çfarë ka ndodhur
gjithë këto vite. Viti 2019 kishte një bum për

se i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë
ka si rezultat i saj, në prag të fushatës elektorale
u bënë shumë rrugë, filluan të shtrohshin rrugët por
që mbetën rrugëve. Dhe më e keqja ishte se fatura
nuk u pagua. Çfarë doja të them me këtë. Secili
prej nesh foli, por nuk prekëm diçka shumë të rëndësishme.
Nuk trajtuam çështjen e borxhit që bashkia ka patur
ndaj të tretëve, se ishte dhe si jemi sot. Në dijeninë
time. pjesa më e madhe e borxhit është e paguar.
Me programin që po ndjek bashkia, mendoj që 6-mujorin
e parë, borxhin ta zerojë. Kjo është një fitore e madhe.
Dikur bashkia ka marrë dhe kredi në bankë për të
bërë investime. Unë dhe Agostini e dimë shumë mirë
këtë gjë. Nuk ka asgjë të keqe të marrësh kredi në
bankë, ashtu sikur nuk ka asgjë të keqe të lidhesh
me donatorë të huaj të sigurosh investime për bashkinë
sepse në fund të fundit po krijon një lloj detyrimi
që e ka ndaj qytetarëve. Por ne kemi marrë mendime
në bankë por ama kemi realizuar shumë pak nga ato
që kemi marrë, gjë që nuk ndodh me këtë bashki.
Jo po pëllim e nise çështjen me një buxhet real
dhe elektoral. Kush mund të mendonte një ditë se
Lezha, do vinte një moment, të jetë pothuajse e
kuruar dhe të na japë mundësinë të mendojmë për
Lezhën drejt së ardhmes. Askëkush. Kush prej
nesh mendoi se një ditë të bukur disa vlera
historike që Lezha i ka patur dhe u shkatërruan

ndër vite, kjo bashki do i kthente në vëmendje. Nuk e kam vetëm për muzeun etnografik por edhe për muzeun historik që do ndërtohet te kalaja. Dikur vetëm diskutohej, por asnjëherë nuk realizohej. Kush mund të mendonte që Lezha, në kuadrin e masivizimit të sportit, do kishte një ekip basketbolli, që do lindte me shumë dyshime, aspak optimiste, dhe brenda një periudhe shumë të shkurtër, do na bënte të besonim që këtu në Lezhë, gjithçka mund të ndodhë. Por ama, ai ekip i ngritur që po na bën krenarë të gjithëve ka nevojë për një pallat sporti. Unë e di që këtë gjë bashkia nuk mund ta realizojë dhe do kërkojë patjetër mbështetje nga ana e pushtetit qendror. Uroj që Lezha ta ketë diçka të tillë se me të vërtetë e meriton kryetar. Përveç kësaj, vijmë te çështje e investimeve në të gjitha drejtimet. Harta e investimeve është një hartë që ka një ndarje të barabartë për të gjitha njësitë, gjithmonë sipas peshës specifike që të secila, ashtu sikurse me investimet e vete në fushën e bujqësisë, prekin pothuajse çdo qelizë. Dhe do kërkoja që në fushën e arsimit, të vazhdojë të investohet më shumë në infrastrukturë, veçanërisht në lidhje me ngrohjen e institucioneve arsimore, që nga zonat më të largëta e deri në zonat bregdetare.
Pjerin Ndreu: Pallati i Sportit do bëhet. Projekti

është gati. Do vazhdojmë te mbështetjen sporti.

- Ndue Luli: Faleminderit. Kush është dakord me projekt vendimin?

U miratua nga të gjithë këshilltarët prezent.

Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore".

Që në momentin që filluam, besoj se u sqarua dhe besoj jemi dakord të kalojmë në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent, përveç z. Agostin Marku që votoi kundër.

→ U larguan këshilltarët Aurela Prendi dhe Albana Lleshaj.

- Ndue Luli: Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për një shtesë në Vendimin nr. 3, datë 01.02.2022 "Për miratimin e listës së të postrehëve që përfitojnë subvencionim të qerasë për vitin 2022"".

Meqë nuk ka diskutime e kalojmë projekt vendimin në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent.

Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022".

Meqë nuk ka diskutime e kalojmë projekt vendimin në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës që është
projekt vendim "Për miratimin e planit të aktiviteteve
të Këshillit Bashkiak Lezhë për vitin 2023."
Kalendaroj projektin "Bashki të Forta" për bashkëpunimin.
Ky është një projekt që e miratojmë sot, por që mund
të ketë ndryshime sipas rrethanave që mund të na
vijnë vitin e ardhshëm.
E kalojmë në votim projekt vendimin.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë,
përveç z. Apostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës që është
projekt vendim "Për disa ndryshime në VKB
nr. 120, datë 29.07.2021 "Për miratimin e komisioneve
të përhershme të Këshillit të Bashkisë Lezhë dhe
përbërjes së tyre".
Siç e dimë, janë larguar këshilltarë, kemi
ardhur këshilltarë të rinj dhe duhet që të caktohen
nëpër komisione.
E kalojmë në votim projekt vendimin.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë,
përveç z. Apostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 9 e rendit të ditës që
është projekt vendim "Për shpalljen e zgjedhjeve
për disa kryetarë të fshatrave".
Këta kryetarë fshatrash që kanë dhënë dorëheqjen,
e kanë dhënë si kryetar, por jo si anëtar,

Kryesisë së Fshatit dhe prandaj duhen bërë zgjedhje, në normalisht bëhen brenda Kryesisë së fshatit, por nuk mund të bëhet emërim.
E kalojmë projekt vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku për votoi kundër.
Kalojmë te pika 10 e rendit të ditës për është projekt vendim "Për ndryshimin e emërtimit të rrugës nr. 03090010, nga "Dragiaj" në "Gjon Kolë Prendi"".
Për këtë rast, ne kemi dërguar kërkesën për verifikimin e figurës në Autoritetin e Dosjeve.
Përgjigje, siç e keni parë në materialet e ubledhjes, ka ardhur dhe e kemi sjellë për miratim.
E kalojmë projekt vendimin në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Vazhdojmë me pikën e parë shtesë për është projekt vendim "Për miratimin e ndihmës financiare për z. Z. P. D. nga fondi i emergjencës".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Vazhdojmë me pikën e dytë shtesë për është projekt vendim "Për miratimin e Gj. N. D. si subjekt përfitues për grante rindërtimi në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë dhe strukturës

së bonimit përkatëse".
Mepsë nuk ka diskutime e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë
Kalojmë te pika e tretë shtesë dhe e fundit
për këtë projekt vendim "Për një ndryshim në
Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 179, datë 28.12.2021
"Për miratimin e linjave të transportit të nxënësve
dhe mësuesve".
Mepsë nuk ka diskutime e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Këto ishin projekt vendimet për mbledhjen e
sotme.
Kalojmë te pika "Të ndryshme".
Kush ka diçka për diskutim
Pjerin Ndreu: Shumë faleminderit për seriozitetin
e treguar.
Ndue Luli: Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ
[signature]

KRYETARI
NDUE LULI
[signature]